



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

14-111/01-0177094/17
Dt.21.07.2017



Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 2, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011, për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.rendor	Niveli	Pozita	Vendim i lirë/Zëvendësim	Numri i pozitive
1	IP	Motër edukatore	Zëvendësim	1
2	IP	Motër edukatore	Vend i lirë	7
3	IP	Edukatore	Zëvendësim	2
4	IP	Edukatore	Vend i lirë	1
5	ShFMU	Edukatore për parafillor	Zëvendësim	2
6	ShFMU	Mësimdhënës/e për mësim klasor	Zëvendësim	16
7	ShFMU	Mësimdhënës/e për mësim klasor	Vend i lirë	16

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë ose në <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Arsimit/Formulare-per-aplikim.aspx>);
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysht.**
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 06/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për motër edukatore (0-3):

- Fakulteti i edukimit – programi në fëmijërinë e hershme 0-3;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi infermiere edukatore;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi pediatri;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi – mami;
- Shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme;

Kriteret e kualifikimit për edukatore (3-6):

- Fakulteti i edukimit – programi para fillor;
- Shkolla e Lartë Pedagogjike – drejtimi për edukatorë;
- Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë;
- Fakulteti i Shkencave Sociale – programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve;

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për mësim klasor:

- Fakulteti i Edukimit – programi fillor;
- Fakulteti i mësuesisë;

SQARIM: Në institucionet parashkollore dhe fillore (1-5), kandidatët duhet të kenë së paku 240 ECTS, përkatësisht 4 vjet.

Në intervistë ftohen vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligj dhe UA (drejtimi adekuat dhe kreditë e mjaftueshme).

Në intervistë, kandidatët do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtëm:

- Njohuri të përgjithshme – 25%;
- Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit – 35%;
- Njohuritë profesionale – 40%, prej të cilave:
 - Nota mesatare – 10%;
 - Përvoja – 10%;
 - Njohuritë mbi vendin e punës – 20%.



III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunës së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2017, por në varësi të liritimit real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **21.07.2017 deri më datën 04.08.2017.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Nëse aplikohet për dy pozita (vend i lirë dhe zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta.

